



Me gjetë punë

Në krahasim me vendet e tjera në Zvicër ka vetëm pak të papunë. Megjithëkëtë punëkërkuessit duhet të plotësojnë kërkesa të larta. Dëftesat dhe diplomat kanë domethënie të madhe. Njohurit në gjuhën gjermane apo frënge janë parakusht i rëndësishëm pothuajse për çdo vend të punës.

Kualifikimet

Profesionet e përfunduara, diplomat dhe kualifikimet e mëtejme kanë në Zvicër gati në të gjitha profesionet vlerë të lartë. Diplomat e huaja nuk pranohen çdoherë. Shumë të rëndësishme gjatë kërkimit të një pune janë edhe dëftesat e punës të punëdhënësit të mëhershëm. Për shumicën e vendeve të punës, njohurit në gjuhën gjermane apo frënge janë të nevojshme. Ngase kantoni i Bernit ka këto dy gjuhë zyrtare, nganjëherë priten njohuri në të dy gjuhët.

Me gjetë një vend pune

Ofertat e vendeve të punës i gjen njeriu në gazeta ditore edhe në portale të ndryshme të internetit. Në portalet e internetit mundet njeriu të paraqitet për abonamente kërkuese, të cilat janë falas. Tutje ka zyra private ndërmjetësuese për punë. Në Zvicër nuk është e jozakonshme me thirr me telefon në një firmë dhe me pyet për punë. Kjo është e mundshme, edhe kur kjo firmë nuk ka shpallur konkurs për një vend të lirë të punës. Qendrat publike rajonale për ndërmjetësim në punë (RAV | ORP) munden me ndihmue gjatë kërkimit të një vendi të punës. Aty ka kompjuter dhe gazeta ditore në dispozicion dhe punonjësit i këshillojnë punëkërkuessit. Njeriu do të duhej t`iu tregoj shumë personave, që është duke kërkuar punë. Kontaktet personale mund të ndihmojnë shumë në gjetjen e një pune.

Aplikimi

Për një vend pune aplikon njeriu normalisht me shkrim. Për një aplikim duhet më s`paku një biografi (CV), një shkresë për motivim dhe nëse është e mundshme një kopje nga dëftesat përfundimtare, diplomat dhe dëftesat e punës. Në shkresën për motivim sqaron njeriu, pse është i interesuar për këtë vend pune dhe pse është personi i duhur për këtë punë. Nëse punëdhënësi është i interesuar, njeriu do të ftohet për një bisedë prezantimi personal (Vorstellungsgespräch | Entretien d'embauche). Për këtë bisedë njeriu do të duhej patjetër mjaftueshëm të përgatitet. Vende të ndryshme ofrojnë mbështetje falas, për përgatitje për aplikim.



Kanton Bern
Canton de Berne

hallo-bern.ch
salut-berne.ch

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-bern.ch/sq/puna/me-gjete-pune

hallo-bern.ch

Informacione për një fillim të mirë në vendbanimin e ri
Puna / Me gjetë punë